

Mendim paralel lidhur me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Zhaneta Pira

Unë Alma Faskaj, anëtare e trupit gjykues, parashtroj mendimin paralel lidhur me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Zhaneta Pira dhe, konkretisht, lidhur me burimet e kryerjes së këtij vlerësimi dhe statusit të saj si jomagjistrate, të arsyetuar në vendim, si vijon:

Subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, ka qenë subjekt rivlerësimi *ex officio* për shkak të detyrës që ushtronte, atë të inspektorit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për këtë kategori subjektësh, ligji nr. 84/2016 parashikonte se procesi i rivlerësimit lidhur me kriterin profesional, parashikonte kritere të tjera për inspektorët magjistratë dhe ata jomagjistratë.

Në pikën 3, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “...3. *Inspektori rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 36, datë 29.4.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ‘Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë’*”.

Po nëse këta inspektorë nuk janë magjistratë zbatohet pika 2, e nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, pra vlerësohen bazuar në relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, si dhe në rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës.

Unë jam e mendimit se subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira gëzon statusin e inspektorit magjistrat për sa vijon:

Organet e rivlerësimit, Komisioni dhe Kolegji, në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, gjatë procesit të rivlerësimit për subjekte të ndryshme, kanë analizuar pasjen ose jo të statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit.

Në vendimin nr. 115, datë 11.3.2019, Komisioni ka analizuar pasjen ose jo të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit M. Xh., në mungesë të një vendimi nga ana e organeve si Këshilli i Lartë Gjyqësor, lidhur me statusin e magjistratit.

Ndërkohë në vendimin nr. 186, datë 23.7.2019, Komisioni iu drejtua KLGJ-së për të qartësuar pasjen ose jo të statusit për subjektin A. F., pavarësisht nga fakti se Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. 30, datë 11.11.2020, nuk ka kërkuar formën e prerë për një vendim të Këshillit duke arsyetuar se: “*Kolegji vlerëson se verifikimi dhe vlerësimi i rrethanave që përcaktojnë aplikimin ose jo të nenit G, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës, e cila përbën edhe vetë kërkimin e subjektit në ankim, është një çështje krejtësisht e juridiksionit të rivlerësimit dhe rregullohet nga kuadri ligjor që normon këtë proces, për pasojë vendimmarrja e Kolegjit në këtë drejtim nuk mund të kondicionohet nga qëndrimet e një gjykate të zakonshme, siç është Gjykata e Apelit Administrativ*”.

Në kushtet kur kemi një organ kompetent, i cili ka marrë një vendim, që është në fuqi, lidhur me statusin e magjistratit të subjektit, kjo çështje duhet të konsiderohet e zgjidhur nga Komisioni dhe nuk lë vend për interpretime ligjore, jashtë objektit të veprimtarisë së Komisionit.

Ky qëndrim është në përputhje, gjithashtu, edhe me qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr. 2/2021, datë 13.1.2021, ku citohet: “*Pavarësisht qëndrimin të subjektit në lidhje me pasjen ose mospasjen prej tij të statusit të magjistratit, kjo çështje konsiderohet e zgjidhur prej Kolegjit në referim të vendimit të KLGJ-së që deklaroi mospasjen*”.

e këtij statusi, vendim i cili nuk rezulton të ketë pasur asnjë kundërshti të ngritur prej subjektit në gjykatën kompetente, për pasojë konsiderohet se ka marrë formë të prerë”.

Për mendimin tim Komisioni nuk ka juridiksion të vlerësojë në rastin konkret çështjen lidhur me statusin e subjektit të rivlerësimit, znj. Zhaneta Pira, në kushtet kur, referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është KLGj-ja organi kompetent për vendimmarrjen lidhur me të.

Sa më sipër, jam e mendimit se në kushtet kur Komisioni ka një vendim të KLGJ-së që deklaron pasjen e statusit të magjistratit, mendoj se trupi gjykues e ka të zgjidhur këtë çështje dhe nuk lë vend për interpretim të kuadrit ligjor e nënligjor dhe karrierën e subjektit, me qëllim përcaktimin nëse subjekti është një inspektor magjistrat apo jomagjistrat.

Për sa më sipër mendoj që, për realizimin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Zhaneta Pira, nuk kërkohet zhvillimi i provimit të magjistraturës, si një nga kushtet kumulative të vlerësimit profesional të inspektorit jomagjistrat.

Ndërkohë shpreh dakordësinë për të gjitha konkluzionet e arritura në vendim lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit.

KOMISIONERE
Alma FASKAJ